



Fusha: Gjuhët dhe komunikimi

Lënda: Gjuhë shqipe/Abetare

Shkalla: I

Klasa: I

Tema :

- 1.Punim ushtrimesh faqja72-73 Abetare
- 2.Shkronja **dh** e **ll**

Situata e të nxënit:

Luaj me shkronjat/
Ëmbëlsirat

Koha: 90'

Rezultatet e të nxënit :

- Reciton vjershën me intonacionin e duhur.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e saj.
- Formon e shkruan fjali me fjalët e dhëna.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.
- Gjen fjalë që kanë në pozicione të ndryshme **dh** e **ll**.
- Përdor kur duhet shkronjën **dh** e **ll** në fjalët e dhëna.

Fjalë kyçe:

akullore, ëmbëltore,
shurup, kaush
tingull bashkëtingëllor

Strategji dhe teknika:

- Stuhi mendimi
- Pyetja sjell pyetjen
- Punë individuale
- Veprimtari në çift
- Analizë/sintezë

Burimet e informacionit dhe mjete:



Teksti i Abetares, shkronja
ilustruese, mjete vizatimi, libra
për fëmijë, fisha ,video
projektor.

Lidhja me fushat e tjera:

- Matematikë
- Art
- Edukim shëndetësor

Hapi i parë:

- Shkruaj në tabelë shkronjat **dh** e **ll**.
- Ndaj nxënësit në dy grupe për të gjetur fjalë që kanë **dh** e **ll** në pozicione të ndryshme. (në fillim ,në mes apo në fund)



- Fjalët e gjetura i shkruajnë në tabelë duke treguar kujdes në lidhjen e tyre me shkronjat e tjera si dhe duke veçuar fjalët që mund të shkruhen gabim. (në vend të **dh** të shkruajnë **ll** e anasjelltas)

(dhoma, dhjeta, dhjetor,
Dhurata,

dhurata, dhemb, dhëmb)

(molla, llokume, akullore,
pëllëmba, llamba)

Paraqes etiketa me fjalë që u
mungojnë rrokje. Nxis nxënësit
të plotësojnë me rrokjen e
duhur duke formuar fjalë me
kuptim. Lexojnë fjalët e
formuara.


kuku __ , mo __ , __ mba,

__ mbi, pë __ mbi,

petu __ , __ ma

Qarkojnë rrokjet që kanë
shkronjat dh e ll.

Hapi i dytë: Në tabelë
shkruaj fjalinë: Ëmbëlsira ime
e preferuar është.....




Orientoj nxënësit të shkruajnë fjalinë të plotë në një fletë dhe e ngjitin në tabelë.

Lexojnë dhe grupohen sipas zgjedhjes që kanë bërë.

- Cila ëmbëlsirë pëlqehet më shumë në klasën tonë?
- Sa nxënës e pëlqejnë?
- Po më pak?
- Ç'kujdes duhet të tregojmë me ëmbëlsirat?
- Pse?
- Vendos në sfond; Kush e hëngri akulloren?

Pyes rreth përmbajtjes së vjershës:



Hapi i tretë:

Nxënësit punojnë ushtrimet në tekst duke bashkëpunuar në dyshe.

Ndihmoj nxënësit që kanë vështirësi:

➤ Ku zhvillohet ngjarja?

➤ Çfarë kishte në park?

➤ Si ishin akulloret?

➤ Pse arushi bleu dy akullore?

➤ Çfarë i ndodhi atij?

Recitim i vjershës nga disa nxënës

● Pëllumbi	bleu	pikë-pikë
● Akullorja.	kullon	akullore.
● Dielli	është	në qiell.
● Drini	solli	letrën.

❖ Pëllumbi solli letrën.

❖ Akullorja kullon pikë-pikë.

❖ Dielli është në qiell.

❖ Drini bleu akullore.

Lexojnë fjalitë e formuara.

Paraqes fjalinë: LLAMBATIBLEUBABI.

Ndajnë fjalët dhe shkruajnë me shkrim shtypi dhe dore fjalinë.

Hapi i katërt:

Veprimtari shkrimi dhe leximi:

Diktim me rrokje, fjalë dhe fjali .

- dha, dhe, lla, llu, llo, dhë
- molla, dhoma, llamba, llokume, dhurata
- Dhurata udhëton me tren.
- Akulloja më pëlen shumë.
- Sa akullore bleu arushi?

Lexim i rrokjeve, fjalëve dhe fjalive të shkruara.

Hapi i pestë:

Shpërndaj tekste të panjohura duke kërkuar të qarkojnë të gjitha shkronjat **dh** e **ll**.

Numërojnë numrin e shkronjave të gjetura.

Vizatim i akullores së preferuar.

Brenda saj shkruajnë fjalë apo fjali sipas dëshirës.



Vlerësoj nxënësin për:

- Reciton vjershën me intonacionin e duhur.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e saj.
- Formon e shkruan fjali me fjalët e dhëna.
- Ruan hapësirat midis fjalëve
- Gjen fjalë që kanë **dh** apo **ll** në pozicione të ndryshme.

- **Detyrë shtëpie:**
- Shkruaj pjesën që të pëlqen.
- Ilustro me vizatim.
- Shkruaj fjalë që kanë **dh** apo **ll** dhe me pesë prej tyre formo fjali.

Mësuesja: **D. Dyrmishi**

Shkolla 9-vjeçare Velabisht

Berat

